

	<b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosova – Republic of Kosovo</b>	
	<b>Komuna e Prishtinës</b> <b>Opština Priština – Municipality of Prishtina</b>	

<b>Datë/a:</b>	10.04.2019
<b>Për/ Za/ To:</b>	OE-ik "Aroma Plus SHPK"
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj - Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit - Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.04.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Krasniqi SH.P.K", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemali, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frashri, Pjeter Bogdani, Shkolla e Gjëlber dhe Mehmet Xhevori, me Nr. të Prok: 616 19 011 211 nxjerr:

## V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazuar** kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik "Aroma Plus SH.P.K", të dt. 08.04.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemali, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frashri, Pjeter Bogdani, Shkolla e Gjëlber dhe Mehmet Xhevori, me Nr. të Prok: 616 19 011 211, kundër njoftimit për kontratë, të datës 25.02.2019 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që ta vazhdoj aktivitetin .
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### **A r s y e t i m**

Eshte konstatuar se pretendimet e OE-ik "Aroma Plus SHPK" janë të pa bazuara për arsyet në vijim:

-Pretendimi i parë është i pa bazuar për faktin se ky aktivitet ka të bëjë me kontratë të shërbimeve dhe në Aneskin e specifikimeve teknike janë paraqitur artikujt që duhet përdorur për realizim të tyre dhe sipas kësaj është detyrë e çdo tenderuesi të interesuar që në bazë të informtave për sasinë dhe llojet e sipërfaqeve të përllogaris sasinë e tyre të nevojshme për pastrim,pra AK-ja nuk është duke blerë artikujt e cekur,por janë cekur vetëm si artikuj të domosdoshëm për realizim të shërbimeve;dhe

-Pretendimi i dytë poashtu është i pa bazuar për faktin se të gjithë OE-ik e dijnë se TVSH-ja duhet të kalkulohet në çmimin total të tenderit,në të cilen është përfshirë edhe përvoja e punës,pra edhe në këtë kategori të çmimit si në çdo kategori tjetër duhet kalkuluar edhe TVSh-në.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.**

#### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**

